

QËLLIMI I MASTERIT

Master-i synon të zhvillojë praktika të standarti-
zuara në formimin e një brezi të ri sipërmarrësish
në sektorin e Turizmit, për krijimin e një kulture të
re të sipërmarrjes dhe të proceseve që karakter-
izojnë dinamizmin e këtij sektori, të ndërlidhur
me shumë fusha (të ndërmarrjeve, ekonomike,
juridike, territoriale). Në fushën e turizmit,
akoma shumë pak të zhvilluar në Shqipëri, dis-
ponibiliteti i figurës së sipërmarrësit inovativ dhe
krijimi i ndërmarrjeve të reja shfaqet si një ele-
ment thelbësor për zhvillimin e sektorit.

Master-i ka si qëllim të mbështesë zhvillimin
ekonomik e kulturor në Shqipëri nëpërmjet për-
gatitjes dhe trajnimit të ekspertëve të kualifi-
kuar, të cilët do të punojnë për sigurimin e një
oferte turistike në përputhje me kërkesat e tregut
ndërkombëtar.

Në nivel sistemi, Masteri kontribuon në zhvillimin
e bashkëpunimit midis dy Vendeve, si në fushën e
Turizmit, ashtu edhe në ngritjen e Sipërmarrjeve të
reja shqiptare dhe italo-shqiptare.

MASTER PROFESIONAL

NGRITJE DHE ZHVILLIM I SIPËRMARRJES NË SEKTORIN E TURIZMIT


START UP DI IMPRESA NEL SETTORE TURISTICO

Diplomë e përbashkët e të dy Universiteteve

Universiteti Katolik “Zoja e Këshillit të Mirë” dhe
Alma Mater Studiorum – Universiteti i Bolonjës,
mbështetur në Urdhërin Nr. 433 datë 12.11.2015
të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit të Republikës
së Shqipërisë dhe në DM 270/4 neni 3, paragrafi
10, të Republikës Italiane, aktivizojnë për vitin
akademik 2015-2016, programin e përbashkët të
studimit:

Master profesional në “Ngritje dhe Zhvillim i
sipërmarrjes në Sektorin e Turizmit” /
Master universitario di primo livello in “Start Up
di Impresa nel Settore Turistico”.

Në përfundimin me sukses të Masterit, të diplo-
muarit do të përfitojnë një diplomë të përbashkët
të të dy universiteteve, e vlefshme për ushtrimin
e profesionit në Shqipëri dhe në Itali.



ADRESA: Kompleksi Spitalor Universitar “Zoja e Këshillit të Mirë”
Rr. Dritan Hoxha, Tiranë, Shqipëri
e-mail: master.economia@unizkm.al
segreteria.economia@unizkm.al
Web: www.unizkm.al
Tel. : 00355 4 2273290



UNIVERSITETI KATOLIK
“ZOJA E KËSHILLIT TË MIRË”



ALMA MATER STUDIORUM
UNIVERSITÀ DI BOLOGNA
CENTRO DI STUDI AVANZATI DI TURISMO

MASTER PROFESIONAL

NGRITJE DHE ZHVILLIM I SIPËRMARRJES NË SEKTORIN E TURIZMIT

START UP DI IMPRESA NEL SETTORE TURISTICO

Edizioni i I
Viti Akademik 2015-2016

Diplomë e përbashkët e të dy Universiteteve



PROFILI PROFESIONAL

Master-i Profesional “Ngritje dhe Zhvillim i Sipërmarrjes në Sektorin e Turizmit” synon të pajisë të diplomuarit dhe sipërmarrësit e ardhshëm me formimin e duhur ekonomiko-juridik dhe me kompetenca të përgjithshme dhe specifike mbi ngritjen e biznesit dhe zhvillimit të sipërmarrjeve të vogla dhe të mesme në sektorin e Turizmit.

Master-i synon gjithashtu t’u japë të diplomuarve njohuri dhe kompetenca mbi problematikat e ekonomisë së ndërmarrjeve (lidhur me menaxhimin, promovimin dhe fillimin e aktiviteteve të sipërmarrjes) si dhe njohuri e kompetenca specifike mbi menaxhimin e aspekteve ligjore, teknike, financiare dhe të drejtimit e menaxhimit të ndërmarrjeve të reja.

Veprimtaritë akademike zhvillohen në 15 lëndë, në formë modulare, dhe me praktikën mësimore që zhvillohet në përfundim të tyre.



PROÇESI MËSIMOR

Mësimdhënia do të zhvillohet në auditoret e Universitetit Katolik “Zoja e Këshillit të Mirë” në Tiranë, me pjesëmarrjen e stafit akademik italian të Universitetit të Bolonjës si dhe me kontributin e ekspertëve të shquar nga bota e financës.

Aktivitetet në laborator do të mundësojnë përvetësimin e teknikave informatike dhe të analizës së të dhënave, ndër më të përdorurat sot në institucionet financiare.

Lëndet e veçanta do të kenë një kohëzgjatje një javore me 18 orë leksion në auditor. Proçesi didaktik do të zhvillohet pasdite.

Masteri do të përfundojë me praktikën mesimore pranë ndërmarrjeve dhe me përgatitjen e një projekti për ngritjen e një Sipërmarrjeje, duke ndërthurur njohuritë teorike të përvetësuara me aspektin praktik profesional.

KRITERET E PRANIMIT

Masteri Ngritje dhe Zhvillim i Sipërmarrjes në Sektorin e Turizmit u drejtohet të diplomuarve me formim ekonomiko-juridik dhe sipërmarrësve të ardhshëm, që dëshirojnë të zhvillojnë aftësi sipërmarrëse, të përgjithshme dhe specifike, për ngritjen e një Sipërmarrjeje në fushën e Turizmit.

Kandidatët duhet të zotërojnë të paktën një Diplomë bachelor në: Shkenca të Turizmit (L-15), Shkenca Ekonomike dhe të Menaxhimit të Ndërmarrjeve (L-18), Shkenca Juridike (L-14), Shkenca Politike dhe të marrëdhënieve ndërkombëtare (L-36), Statistike (L-14).

Diplomat në: Inxhinieri Civile dhe Mjedisore (L-7), Inxhinieri Informatike (L-8), Inxhinieri Industriale (L-9), Shkenca Matematike (L-35), Shkenca dhe Teknologji Fizike (L-30) edhe të tjera do të merren në konsideratë, në funksion të projekteve specifike të kualifikimit të kandidatëve, të konsideruar të pranueshëm nga Komisioni përzgjedhës.

Njohja e gjuhëve angleze dhe italiane si dhe njohuri bazë të informatikës janë të nevojshme. Lëndë të veçanta mund të ndiqen edhe nga persona me statusin e dëgjuesit, për jo më shumë se 5 orë/lëndë.

